



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

Prishtinë/Priština, rr./ul. Bedri Pejani nr./br. 7, tel. +381 (0) 38 225 211; kqz.sekretariati@cec-ko.org; www.cec-ko.org

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Regjistrimi i partisë Stranka Demokratski Promjena -SDP (Partia e Ndryshimeve Demokratike), i hapur për shqyrtim publik

Prishtinë, 18 dhjetor 2008 – Partia e Ndryshimeve Demokratike (SDP) sot ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës shtatë (7) ditore, gjatë të cilës publiku mund të shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

SDP është themeluar më 20 tetor 2008 nga Safet Zoranić dhe sipas programit të saj “SDP synon që me mjete politike të realizoj parimet e demokracisë parlamentare për liri, barazi, mirëkuptim, dhe mirëqenie të të gjithë komuniteteve në Kosovë”.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike është themeluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 25 shtator 2008.

Zyrës për Regjistrim të Partive Politike i është dhënë përgjegjësia për regjistrimin e partive politike në Kosovë, nga Ligji mbi Zgjedhjet në Kosovë dhe sipas Rregullës të KQZ-së. ‘Mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë’

“Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës”.

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe shenjën do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Zyra për regjistrim të partive politike gjendet në Rr. Bedri Pejani nr.7 në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 18 dhjetor deri më 26 dhjetor 2008. Për informatë shtesë mund të kontaktoni znj. Miradije Mavriqi, Zyra për Regjistrim të Partive Politike/ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 225 207 ext 116.